

“ RAFIN COMPANY “ SHPK

Pasqyrat Financiare 2020

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Informacione te pergjitheshme

“RAFIN COMPANY ” SHPK, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 23 Shtator 2015 dhe Rregjistruar prane Qendes Kombetare te Rregjistrimit me 25 Shtator 2015. Kapitali rregjistruar eshte 21 000 000 leke dhe zoterohet nga ortaku themelues, Renido PETRITAJ .

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise eshte Ne fushen e Ndertimeve te Ndryshme. Ne fushen e tregtetimit me pakice dhe shumice, importi dhe eksporti te : veshmbathje, konfeksione, hidrosanitare, hidraulik etj.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar ‘Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare’ dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të permisuar. Ato janë përgatitur mbi bazen e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhen vendase, Lekë Shqiptar (“lekë).

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit janë zbatuar për here të pare në vitin 2008 dhe aplikimi i tyre, sipas kërkesave të SNK-ve të permirsuar, është bërë në mënyrë perspektive.

Ne paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2020 është zbatuar formati i SKK-2.

Shoqëria i ndërton dhe i paraqet Pasqyrat Financiare sipas **SKK TE PERMIRESUARA** në bazë të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 4 i ndryshuar me Vendimin nr 1, date 25.06.2014 të Keshillit Kombëtar të Kontabilitetit “PER MIRATIMIN E STANDARTEVE KOMBETARE TE KONTABILITETIT TE PERMIRESUARA” si dhe Urdheri i Ministrit të Financave nr 64, date 22 07.2014 “PER ZBATIMIN E DETYRUESHEM TE STANDARTEVE KOMBETARE TE KONTABILITETIT TE PERMIRESUARA “ nga data 01 01.2015. Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke ndjekur e zbatuar **Politikat Kryesore Kontabel** si : politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave e shpenzimeve si dhe njohjen dhe vlerësimin e tyre. Gjithashtu gjatë përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë pasur parasysh **Parimet** si: Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i Njesise Ekonomike Raportuese, Parimi i vijimesise se veprimtarise ekonomike si dhe Parimi i Kompesimit. **Karakteristikat** çilesore të përgatitjes së Pasqyrave Financiare janë ato që e bëjnë informacionin e pasqyrave financiare të dobishëm për perdoruesin. Karakteristikat kryesore që janë mbajtur parasysh gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare janë: Kuptueshmëria, Rendësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i Paraqitjes me Besnikëri parimi i Perparemise se permbajtjes ekonomike mbi formen ligjore, Paanshmëria, Parimi i maturise, Parimi i plotësisë. Qendrushmëria dhe Krahasueshmëria.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:

Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të treta dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura.



“ RAFIN COMPANY “SHPK

Pasqyrat Financiare 2020

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 janë 1 euro=123.7 leke dhe 1 usd=100.84 leke.

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2020 është 15 % .

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në para regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuara. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në para, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e kostos. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi llogaritet mbi bazën e vlerës se mbetur për ndertesat dhe mbi bazën e vlerës se mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e përdorura janë në ndërtesa 5 % të vlerës se mbetur dhe për aktivet e tjera ku futen mjetet e transportit 20% të vlerës se mbetur dhe për AQT ku futen pajisje zyre dhe informatike është përdorur norma e amortizimit 25 % e vlerës se mbetur..

Gjendjet e inventareve

Vlerësimi në hyrje i inventareve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjelle inventaret në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kosto mesatare të blerjeve të ushtrimit që nga drejtimi është çnuar si vlera neto të realizueshme.



“ RAFIN COMPANY “SHPK

Pasqyrat Financiare 2020

▪ Shpenzime personeli

Numri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte

Kategorite	Ushtrimi 2020(000 leke)			Ushtrimi 2019(000 leke)		
	Numer mesatar	Paga	Sgurime punedhenesi	Numer mesatar	Paga	Sgurime punedhenesi
Administrator, menaxher	1	480	80	1	480	80
Specialist me arsim universitar	20	6,720	1,122	20	6,720	1,122
Teknike	-	-	-	-	-	-
Puntor	99	12,089	1,992	81	12,089	1,992
		-				
Shuma	120	19,289	3,194	102	19,289	3,194

9. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2020 dhe 2019 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2019
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	26,255,862	16,063,672
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	620,038	139,395
1 Amortizime tej normave fiskale	-	-
2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor	-	-
3 Gjoba,penalitetete,demshperblime	620,038	139,395
4 Provizione qe nuk njihen	-	-
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	-	-
6 Te tjera-materiale jashte perdorimit(pa miratim)	-	-
III PJESA E HUMBJES SE MBARTUR(-)	-	-
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE(I+II-III)	26,875,900	16,203,067
V Shpenzimi i tatim fitimit-15%	4,031,385	2,430,460
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT(I-V)	22,224,477	13,633,212

Shoqeria rezulton me fitim per vitin 2020 ne vleren 22 182 113 leke.

10. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , nuk ka transaksione te tjera me palet e lidhura.

11. Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2020 jane klasifikuar sipas standarteve duke iu pershtatur prezantimit te pasqyrave financiare te vitit aktual, te cilat jane ndertuar sipas SNK-ve .

Administratori I Shoqerise

Renido PETRITAJ

